



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 124

Tiranë – E premte, 3 korrik 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 58/2020 datë 30.4.2020	Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (<i>Multy Buoy Mooring</i>)”, të ndryshuar..... 7443
Vendim i Kuvendit nr. 31/2020, datë 25.6.2020	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 486, datë 22.5.2020, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr. 58/2020 ‘Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës ‘BOT’ (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM, në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare ‘Porti MBM’ (<i>Multy Buoy Mooring</i>)’, të ndryshuar”..... 7447
Vendim i Kuvendit nr. 34/2020, datë 2.7.2020	Për miratimin e dekretit nr. 11 498, datë 4.6.2020 të Presidentit të Republikës “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”... 7447
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 1.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 7447
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 2.7.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar..... 7448
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 24.6.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sot Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të godinës së ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (pjesë e ish-hotel “Arbëria”)..... 7456
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 24.6.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të godinës së ish-Ministrisë së Integritimit Evropian..... 7458



LIGJ
Nr. 58/2020

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË
KONTRATËS SË KONCESIONIT TË
FORMËS “BOT” (NDËRTIM,
SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË
NJË PORTI TË LLOJIT MBM NË
PORTO-ROMANO, DURRËS,
MIRATUAR ME LIGJIN NR. 104/2015,
NDËRMJET MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DHE SHOQËRISË KONCESIONARE
“PORTI MBM (*MULTY BUOY
MOORING*)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.4.2020

KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR SHITESË NË KONTRATËN E
KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE
TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË LLOJIT
MBM NË PORTO-ROMANO, DURRËS,
MIRATUAR ME LIGJIN NR. 104/2015,
NDËRMJET MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE
SHOQËRISË KONCESIONARE “PORTI
MBM (*MULTY BUOY MOORING*)”,
TË NDRYSHUAR

E lidhur sot më datë 31.3.2020, midis palëve kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizimin nr. 1883/1 prot., datë 18.2.2020, nga zëvendësministri, z. Ilir Bejtja, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

dhe

Shoqëria koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)” sh.p.k., regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L51621501S, me seli në adresën Porto-Romano, Durrës, përfaqësuar nga administratori, z. Ahmet Kastrati shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Palët, të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë kontratë koncesioni shtesë, si pjesë përbërëse e kontratës së koncesionit e miratuar me ligjin nr. 104/2015 “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës ‘BOT’ (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare ‘Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)’” dhe të ndryshuar me ligjin nr. 13/2018.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Ndërmjet ish-Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*MultyBuoyMooring*)”, më datë 21.7.2015, është firmosur një kontratë koncesioni e formës “BOT”, e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 104/2015,



“Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, të ndryshuar me ligjin nr. 13/2018;

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, është ministria përgjegjëse për shfrytëzimin e porteve dhe autoritet kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor;

- Shoqëria “Porti MBM” ka paraqitur me shkresën nr. 24/01, datë 24.2.2020, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kërkesën për shtesë në kontratën e koncesionit, e cila ka si qëllim shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të portit;

- Palët njohin dhe pranojnë faktin që shtesa e propozuar nuk ka si qëllim ndryshimin e kushteve të tjera thelbësore të kontratës koncesionare; si dhe

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjen të argumentuar kërkesën e shoqërisë, që kërkon të shfrytëzojë maksimalisht kapacitetet e portit;

Bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Në fund të pikës 3.1, të nenit 3 “Objekti i koncesionit” shtohet fjalia:

“Koncesionari mund të ngarkojë-shkarkojë dhe përpunojë në këtë port, anije që transportojnë mallra të tjera.”.

Neni 2

Aneksi 1/1 i kontratës koncesionare, të ndryshuar, zëvendësohet me aneksin 1.1 bashkëlidhur kësaj shtese kontrate.

Neni 3

Kjo kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë. Kjo kontratë, pasi nënshkruhet nga palët, hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjit që do ta miratojë.

Palët

AUTORITETI KONTRAKTUES
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përfaqësuar nga:
z. Ilir Bejtja


SHOQËRIA KONCESIONARE
“Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)” sh.p.k.
Përfaqësuar nga:
z. Ahmet Kastrati

ANEKSI 1.1

POZICIONI GJEOGRAFIK - “Porti MBM”, Porto-Romano, Durrës

Pjesa e pare:

Zona e individualizuar ku do te vendosen bovat MBM, ndodhet në afërsi të bregdetit shqiptar mbi 2,500 m nga vija bregdetare në afërsi të Porto-Romanos, Durrës, brenda koordinatave:



Pjesa e dytë është pjesa e distributorëve shpërndarës. Distributorët shpërndarës shërbejnë për lidhjen e operatorëve të ndryshëm që duan të shfrytëzojnë Portin MBM. Salla e kontrollit ndodhet në koordinatat:

Pika “P1” N-41°22'32.520"
E-19°25'19.200"

Për të kryer operacionet në tokë duhet një sipërfaqe toke prej 3,850 m². Kjo sipërfaqe është paralel me rrugën ekzistuese për në Romano-Porto me distancë 12 ml nga aksi i saj, për të mos penguar edhe zgjerimin në perspektivë të kësaj pjese të rrugës. Sipërfaqja e nevojshme është në formë paralelogrami (me gjatësi mesatare) 77 ml dhe gjerësi 50 ml dhe me sipërfaqe 3,850 m². Brenda këtij sheshi duhet të ndërtohet infrastruktura e nevojshme për shfrytëzimin optimal të portit MBM. Për përmirësimin e shërbimit të operacioneve në tokë do të përdoret edhe një sipërfaqe prej 7315 m² e cila është në posedim dhe përdorim nga koncesionari, referuar kartelave të pasurive në ZK 3184, nr. pas 93/2, dhe nr. pas 94/2

Pjesa e tretë është e ndarë në tre sektorë:

- a- Sektori i argjinaturës mbajtëse të tubave me shtrirje nga vija e intersektimit të tokës me detin me gjatësi 1378ml, në det, me profil gjatësor nga +/-0.00 deri në thellësinë -10.00 me gjerësi të pjesës së sipërme të argjinaturës 10 ml.

Koordinatat gjeografike të kësaj argjinature janë:

Pika “P2” N-41°22'25.07148"
E-19°24'49.41114"

Pika “P3” N-41°22'33.29830"
E-19°25'18.43707"

Pika “P4” N-41°21'49.92000"
E-19°24'32.30000"

Pika “P5” N-41°21'50.48000"
E-19°24'35.27000"


- b- Sektori i shtrirjes së tubave nga argjinatura në taban të detit është me gjatësi mbi 1250ml deri në sektorin e bove të lidhura me Plemën.

Tubacionet për sektorin a dhe b do të jenë me diametër 323.9 mm. Keto tubacione janë të mbrojtur me shtresë gome, dy prej të cilëve janë të veshur me beton me trashësi 2 cm, për ruajtjen

nga goditjet mekanike të mundshme dhe ai që do të shërbejë për transportimin e bitumit do të jetë i pajisur me kundërtub për kontrollin e temperaturës.

c-Në anën jugore të kësaj argjinature ndodhen kalatat 1,2,3 për akostimin dhe përpunimin e mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure, të pozicionuara përgjatë argjinaturës.

Tubacionet që do të shërbejnë për transportimin e lëndëve hidrokarbure, si psh: diesel, benzene, mazut, solare naphta, biokarbonat, bitum, naftë bruto, etj., duhet të përmbushin standardet në fuqi.



Pjesa e katërt:

Është argjinatura mbrojtëse e strukturës e vendosur në anën jugore të saj, me formë planimetricke si në skicën me sipër. Kjo strukturë është me gjatësi mbi 500 ml, me konfiguracionin e tillë që të përballojë dallgëzimin maksimal të detit dhe për mbrojtjen e gjithë strukturës në det.

Në gjatësinë e kësaj argjinature vendosen kalatat Jug-Lindore me numër 4,5,6 për përpunimin e mjeteve lundruese që transportojnë mallra të tjera.

Koordinata gjeografike të kësaj argjinature janë:

Pika "P6" N- 41°22'15.47132"
E-19°25'06.45369"

Pika "P7" N- 41°22'08.19861"
E- 19°24'47.41062"

Pika "P8" N- 41°22'07.89630"
E-19°24'43.12646"

Pika "P9" N- 41°22'09.16808"
E- 19°24'38.71361"

Pika "P10" N- 41°22'12.34902"
E-19°24'34.95584"

Pika "P11" N- 41°22'16.33018"
E- 19°24'33.96351"

**VENDIM**
Nr. 31/2020

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 486, DATË 22.5.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN NË KUVEND TË LIGJIT NR. 58/2020 ‘PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS ‘BOT’ (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË LLOJIT MBM, NË PORTO-ROMANO, DURRËS, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 104/2015, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE ‘PORTI MBM’ (MULTY BUOY MOORING), TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 486, datë 22.5.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr. 58/2020 ‘Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës ‘BOT’ (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM, në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqërisë Koncesionare ‘Porti MBM’ (*Multy Buoy Mooring*)’, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 25.6.2020

VENDIM
Nr. 34/2020

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT NR. 11 498, DATË 4.6.2020 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR PROPOZIMIN E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 162, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 111, pika 7, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të zgjedhë kandidaturën e zotit Arben Shehu, Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të propozuar me dekretin nr. 11 498, datë 4.6.2020, të Presidentit të Republikës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 2.7.2020

AKT NORMATIV
Nr. 27, datë 1.7.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9936, DATË 26.6.2008, “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



Neni 1

Pas pikës 49, të nenit 3, shtohet pika 50, me këtë përmbajtje:

“50. “Balanca primare buxhetore” është sa të ardhurat totale buxhetore minus shpenzimet totale buxhetore plus shpenzimet për interesa.”.

Neni 2

Në nenin 4/1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk duhet të rezultojë më e vogël sesa zero, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV
Nr. 28, datë 2.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.88/2019, “PËR BUXHETIN E VITIT
2020”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2020 është:

Të ardhurat	446 570 milionë lekë;
Shpenzimet	579 535 milionë lekë;
Deficiti	132 965 milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2020 është:

Të ardhurat	328 525 milionë lekë;
Shpenzimet	461 490 milionë lekë;
Deficiti	132 965 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2020 është:

Të ardhurat	53 485 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 200 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	7 840 milionë lekë;
- Të ardhura të tjera	27 445 milionë lekë;
Shpenzimet	53 485 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2020 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat, gjithsej,	132 530 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	79 340 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	51 190 milionë lekë;



- transferta nga

buxheti për

indeksimin e

pensioneve

Shpenzimet

2 000 milionë lekë;

132 530 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2020, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej, 6 538 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet 1 500 milionë lekë;

- transferimet nga 4 938 milionë lekë;

buxheti i shtetit

- fondi për indeksimin 100 milionë lekë;

e pensioneve

Shpenzimet 6 538 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 100 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 650 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta. Instituti i Sigurimeve Shoqërore autorizohet të përdorë gjendjen në llogarinë bankare mbi fondin rezervë, përpara përdorimit të transfertës së buxhetit të shtetit, gjithmonë duke ruajtur tavanin e shpenzimeve të përcaktuar më sipër. Në rast se nevojitet, ministria përgjegjëse për financat autorizon përdorimin e fondit rezervë të ISSH-së.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2020 është:

Të ardhurat, gjithsej, 45 304 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet dhe të

tjera

13 160 milionë lekë;

- transferimet nga

buxheti i shtetit

32 144 milionë lekë;

Shpenzimet

45 304 milionë lekë

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë edhe detyrimet e prapambetura. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2020 është:

Të ardhurat, gjithsej 4 000 milionë lekë;

Nga të cilat:

- të ardhura të tjera 1 000 milionë lekë;

- transferimet nga

buxheti i shtetit

3 000 milionë lekë;

Shpenzimet

4 000 milionë lekë.”.

Neni 2

Në nenin 7, fondi i rindërtimit ndryshohet dhe bëhet “... 34 miliardë lekësh ...” dhe nënndarjet e dytë dhe e tretë ndryshohen, si më poshtë vijon:

“- Grante 3 miliardë lekë.

Shpenzime të buxhetit të shtetit 31 miliardë lekë.”.

Neni 3

Nenet 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon;

“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet 18 000 milionë lekë;

Të ardhurat tatimore 290 000 milionë lekë;

Të ardhurat

jotatimore

20 525 milionë lekë.



Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër sesa deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 49 900 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë së Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë.

Në financimin neto nga burimet e huaja përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikativë, si më poshtë vijon:

- Huamarrje afatgjata, të destinuara për projekte, me vlerë rreth 15 184 milionë lekë;
- Huamarrje nga eurobondi, me vlerë prej rreth 80 177 milionë lekësh;
- Huamarrje në formë të “mbështetjes buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare, me vlerë rreth 49 833 milionë lekë;

-Ripagesa të principalit, me vlerë rreth 62 600 milionë lekë.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis huamarrjes totale neto dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në llogarinë e Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose në rast mungese përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2020, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit 441 190 milionë lekë; qendror
- Fondi rezervë 2 700 milionë lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit 4 100 milionë lekë;
- Kontingjencë për paketën antiCovid-19 13 500 milionë lekë.

2. Paragrafi i fundit shfuqizohet.

3. Tabelat 1 dhe 4, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohen përkatësisht me tabelat me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhën këtij akti.

Neni 4

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Numri i punonjësve ndryshohet dhe bëhet “...83 117 veta...”.
2. Fondi i veçantë ndryshohet dhe bëhet “... 240 milionë lekë...”.
3. Tabela nr.2, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti.

Neni 5

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon;

“Neni 14

Fondi rezervë i buxhetit prej 16 200 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave, si më poshtë vijon:

- 2 700 milionë lekë për raste të papara-shikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme.
- 13 500 milionë lekë si kontingjencë për paketën sociale antiCovid-19.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 100 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë i buxhetit dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.



Neni 6

-Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 750 milionë lekë.

Nenet 19 dhe 20 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2020, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 159 769 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore deri në 132 494 milionë lekë.

- Kufiri për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 27 275 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 272 563 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 202 685 milionë lekë.

- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 69 128 milionë lekë.

Neni 20

Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe të mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve totale buxhetore.”

Neni 7

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 8

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKTI NORMATIV 2020 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financim i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	Presidenca	229,300	6,000	0	6,000	235,300
01120	Veprimtaria e Presidentit	229,300	6,000	0	6,000	235,300
2	Kuvendi	1,031,160	198,000	0	198,000	1,229,160
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	399,425	198,000	0	198,000	597,425
01120	Veprimtaria Ligjvënese	631,735	0	0	0	631,735
3	Kryeministria	437,000	99,000	100,000	199,000	636,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	437,000	99,000	100,000	199,000	636,000
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	4,182,500	2,997,000	3,630,300	6,627,300	10,809,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	309,000	4,000	0	4,000	313,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,127,500	135,204	239,918	375,122	1,502,622
04240	Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes	649,000	2,070,000	1,405,800	3,475,800	4,124,800
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	1,500,000	644,761	1,873,432	2,518,193	4,018,193
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqësor	472,000	16,000	0	16,000	488,000
05470	Menaxhimi qendruar në tokë bujqësore	15,000	0	0	0	15,000
04230	Mbështetje për Peshkimin	110,000	127,035	111,150	238,185	348,185
6	Ministria e Infrastruktures dhe Energji	3,972,515	27,867,408	13,329,543	41,196,951	45,169,466
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	491,956	9,500	0	9,500	501,456
04520	Transporti rrugor	1,502,000	20,642,136	6,503,132	27,145,268	28,647,268
04540	Transporti Detar	108,009	45,000	0	45,000	153,009
04550	Transporti Hekurudhor	423,700	85,700	400,000	485,700	909,400
04560	Transporti Ajror	20,200	35,000	0	35,000	55,200
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	373,500	5,469,800	3,816,411	9,286,211	9,659,711
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	500,000	1,162,272	630,000	1,792,272	2,292,272
04320	Mbështetje për Energji	87,900	168,000	1,760,000	1,928,000	2,015,900
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	147,000	87,000	0	87,000	234,000
04440	Mbështetje për Industrinë	287,150	85,000	0	85,000	372,150
06180	Planifikimi Urban	31,100	78,000	220,000	298,000	329,100
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	66,008,850	1,918,689	1,138,000	3,056,689	69,065,539
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	599,500	223,000	350,000	573,000	1,172,500
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	377,000	0	0	0	377,000
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	400,000	200,000	0	200,000	600,000
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,657,000	417,000	0	417,000	3,074,000



Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financim i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	2,875,000	153,220	84,100	237,320	3,112,320
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	78,900	2,000	0	2,000	80,900
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	263,500	25,000	150,000	175,000	438,500
04160	Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	290,500	16,000	0	16,000	306,500
10220	Sigurimi Shogoror	51,070,150	0	0	0	51,070,150
10550	Tregu i Punes	2,042,500	85,000	0	85,000	2,127,500
04170	Inspektimi ne Pune	165,300	2,000	0	2,000	167,300
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	1,980,500	475,469	553,900	1,029,369	3,009,869
06190	Strehimi	3,209,000	320,000	0	320,000	3,529,000
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	38,327,763	3,025,200	216,000	3,241,200	41,568,963
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	667,000	22,000	0	22,000	689,000
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	21,918,720	1,117,000	0	1,117,000	23,035,720
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,182,043	842,000	0	842,000	7,024,043
09450	Arsimi Universitar	9,000,000	930,000	100,000	1,030,000	10,030,000
09770	Fonde per Shkencen	340,000	100,000	100,000	200,000	540,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	220,000	14,200	16,000	30,200	250,200
12	Ministria e Kultures	1,455,881	532,000	180,323	712,323	2,168,204
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	155,000	0	0	0	155,000
08220	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	535,881	15,500	35,323	50,823	586,704
08230	Arti dhe Kultura	765,000	516,500	145,000	661,500	1,426,500
13	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	62,423,940	1,862,000	1,110,000	2,972,000	65,395,940
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	418,940	4,128	0	4,128	423,068
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7,636,862	526,276	158,000	684,276	8,321,138
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	26,158,450	1,271,014	852,000	2,123,014	28,281,464
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	2,984,428	13,500	0	13,500	2,997,928
07460	Sherbimi Kombetar i Urgjences	288,500	23,182	0	23,182	311,682
10430	Perkujdesi Social	23,900,760	22,700	100,000	122,700	24,023,460
01190	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	1,036,000	1,200	0	1,200	1,037,200
14	Ministria e Drejtesise	9,450,241	439,174	225,000	664,174	10,114,415
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	336,966	100,300	225,000	325,300	662,266
03310	Ndihma Juridike	45,400	0	0	0	45,400
01120	Publikimet Zyrtare	50,453	5,000	0	5,000	55,453
01130	Mjekesia Ligjore	75,940	10,000	0	10,000	85,940
03440	Sistemi i Burgjeve	5,362,916	320,374	0	320,374	5,683,290
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	140,050	0	0	0	140,050
01160	Sherbimet per cheshtjet e biresimeve	13,350	2,000	0	2,000	15,350
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	3,231,396	1,000	0	1,000	3,232,396
03490	Sherbimi i Proves	193,770	500	0	500	194,270
15	Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme	3,108,100	29,500	134,780	164,280	3,272,380
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	142,600	2,000	0	2,000	144,600
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,636,500	7,000	0	7,000	2,643,500
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	237,000	0	0	0	237,000
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimit	92,000	20,500	134,780	155,280	247,280
16	Ministria e Brendshme	18,897,729	1,397,551	818,868	2,216,419	21,114,148
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,025,500	612,400	0	612,400	1,637,900
03140	Policia e Shtetit	15,230,729	657,151	818,868	1,476,019	16,706,748
03150	Garda e Republikes	1,520,000	55,000	0	55,000	1,575,000
01160	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	483,000	71,000	0	71,000	554,000
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	638,500	2,000	0	2,000	640,500
17	Ministria e Mbrojtjes	19,332,581	3,650,014	119,250	3,769,264	23,101,845
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,189,000	31,450	0	31,450	1,220,450
02120	Forcat e Luftimit	5,491,707	2,566,764	0	2,566,764	8,058,471
09430	Arsimi Ushtarak	593,050	110,000	0	110,000	703,050
02150	Mbeshtetja e Luftimit	5,641,960	230,800	0	230,800	5,872,760
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	1,026,864	50,000	0	50,000	1,076,864
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	5,060,000	0	0	0	5,060,000
10910	Emergjencat Civile	330,000	661,000	119,250	780,250	1,110,250
18	Sherbimi Informativ Shtetror	1,795,000	46,500	0	46,500	1,841,500
03520	Veprimtaria Informative Shtetore	1,795,000	46,500	0	46,500	1,841,500
19	Drejtoria e Radio Televizionit	564,000	70,000	0	70,000	634,000
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	270,000	0	0	0	270,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	180,000	70,000	0	70,000	250,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	60,000	0	0	0	60,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	54,000	0	0	0	54,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	179,000	105,000	0	105,000	284,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	179,000	105,000	0	105,000	284,000
22	Akademia e Shkences	92,000	1,000	0	1,000	93,000
01520	Veprimtaria Akademike	92,000	1,000	0	1,000	93,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	384,000	18,000	18,036	36,036	420,036
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	384,000	18,000	18,036	36,036	420,036
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,273,630	555,600	390,000	945,600	2,219,230
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	196,000	2,085	0	2,085	198,085
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	484,000	203,953	240,000	443,953	927,953
04260	Administrimi i Pyjeve	437,000	89,962	100,000	189,962	626,962
04760	Zhvillimi i Turizmit	156,630	259,600	50,000	309,600	466,230
28	Prokuroria e Pergjithshme	2,168,800	130,000	0	130,000	2,298,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,168,800	130,000	0	130,000	2,298,800
29	Keshilli i Larte i Gjyqesor	2,939,150	208,000	0	208,000	3,147,150
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	243,150	49,600	0	49,600	292,750
03310	Buxheti Gjyqesor	2,696,000	158,400	0	158,400	2,854,400
30	Gjykata Kushtetuese	113,000	2,000	0	2,000	115,000
03320	Veprimtaria Gjyqesore Kushtetuese	113,000	2,000	0	2,000	115,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	66,650	1,000	0	1,000	67,650
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	66,650	1,000	0	1,000	67,650
35	Keshilli i Larte i Prokurorisë	126,524	17,000	0	17,000	143,524
01110	Veprimtaria e KLP	126,524	17,000	0	17,000	143,524
40	Partite Politike	150,000	0	0	0	150,000
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	140,000	0	0	0	140,000



Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financim i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01120	Mbeshtetje per Shogatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	2,000	0	0	0	2,000
41	Struktura e Posaqme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	341,055	20,000	0	20,000	361,055
03390	Veprimtaria e SPAK	341,055	20,000	0	20,000	361,055
50	Instituti Statistikës	613,000	74,000	300,000	374,000	987,000
01320	Veprimtaria Statistikore	613,000	74,000	300,000	374,000	987,000
55	Shkolla e Magjistratures	187,000	3,000	0	3,000	190,000
09820	Veprimtaria Arsimore	187,000	3,000	0	3,000	190,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	12,196,000	5,702,000	17,898,000	17,898,000
06210	Programe Zhvillimi	0	7,496,000	5,702,000	13,198,000	13,198,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	4,500,000	0	4,500,000	4,500,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	200,000	0	200,000	200,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	146,220	1,000	13,400	14,400	160,620
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	146,220	1,000	13,400	14,400	160,620
63	Institucionet e sistemit te drejtesise	466,300	14,000	0	14,000	480,300
03320	Veprimtaria e Inspektoriatit te Larte te Drejtesise	89,200	7,000	0	7,000	96,200
03330	Veprimtaria e rivleresimit kalimtar te magjistratit	186,200	4,000	0	4,000	190,200
03340	Veprimtaria e apelimit te rivleresimit kalimtar	125,000	2,000	0	2,000	127,000
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	65,900	1,000	0	1,000	66,900
66	Avokati i Popullit	113,540	1,000	0	1,000	114,540
03320	Sherbimi i avokatise	113,540	1,000	0	1,000	114,540
67	Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil	54,466	0	0	0	54,466
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	54,466	0	0	0	54,466
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	125,600	500	0	500	126,100
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	125,600	500	0	500	126,100
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	152,500	2,000	0	2,000	154,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	152,500	2,000	0	2,000	154,500
77	Autoriteti i Konkurences	74,500	1,000	0	1,000	75,500
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	74,500	1,000	0	1,000	75,500
82	Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	11,120	1,000	0	1,000	12,120
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	11,120	1,000	0	1,000	12,120
87	Institucione te tjera Qeveritare	5,137,156	1,657,864	250,800	1,908,664	7,045,820
01320	Sherbime Qeveritare	250,000	30,000	0	30,000	280,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	58,300	8,000	0	8,000	66,300
01120	Sherbimi per diasporen	115,500	76,750	0	76,750	192,250
05640	Administrimi i ujrave	80,900	5,000	93,000	98,000	178,900
03310	Sherbimi i Avokatise Shtetore	212,000	1,000	0	1,000	213,000
01150	Sherbime te tjera	388,989	26,500	0	26,500	415,489
01140	e-Qeverisja	3,569,567	1,456,614	7,800	1,464,414	5,033,981
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	330,500	54,000	150,000	204,000	534,500
08480	Mbeshtetje per Kultet Fetare	131,400	0	0	0	131,400
88	Mbeshtetje per Shoqerine Civile	82,500	1,000	0	1,000	83,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	82,500	1,000	0	1,000	83,500
89	Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	65,626	1,000	0	1,000	66,626
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	65,626	1,000	0	1,000	66,626
90	Komisioni i Prokurimit Publik	62,000	1,000	0	1,000	63,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	62,000	1,000	0	1,000	63,000
91	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	49,810	1,000	0	1,000	50,810
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	49,810	1,000	0	1,000	50,810
92	Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	30,500	1,000	0	1,000	31,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,500	1,000	0	1,000	31,500
95	Autoriteti per te Drejten e Informimit	77,000	1,000	8,000	9,000	86,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	77,000	1,000	8,000	9,000	86,000
TOTALI		246,499,207	59,153,000	27,684,300	86,837,300	333,336,507



Kod min	Emërtimi i Ministrisë / Institucionit Buxhetor	AN 2020
1	Presidenca	86
2	Kuvendi	407
3	Kryeministria	162
5	Ministria e Bujqësisë	1,967
6	Ministria e Infrastrukturës /Energjisë	1,033
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5,986
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	31,011
12	Ministria e Kulturës	1,002
13	Ministria e Shendetësisë	4,257
14	Ministria e Drejtësisë	5,322
15	Ministër Punët e Jashtme	565
16	Ministria e Brendshme	15,071
17	Ministria e Mbrojtjes	8,863
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	203
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	879
28	Prokuroria e Përgjithshme	928
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1,593
30	Gjykata Kushtetuese	62
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	50
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	65
41	SPAK/Byro hetimi	100
50	Instituti Statistikës	236
55	Shkolla e Magjistraturës	35
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	64
63	Kolegji i Posacem i Apelit	43
63	Komisioneri Publik	30
63	Inspektoriat Lartë i Drejtësisë	93
66	Avokati i Popullit	56
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	31
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	71
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	70
77	Autoriteti i Konkurrencës	46
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera Qeveritare	1,205
	<i>Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar (DSIK)</i>	38
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	44
	<i>Komiteti për Pakicat Kombëtare</i>	20
	<i>Inspektoriat Qendror</i>	21
	<i>Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore</i>	83
	<i>Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit</i>	8
	<i>Agjencia për Diasporën</i>	16
	<i>Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët</i>	12
	<i>Qendra Botimeve të Diasporës</i>	15
	<i>Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkeqeverisje</i>	42
	<i>Agjencia e Zhvillimit të Territorit</i>	43
	<i>Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit</i>	41
	<i>Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE</i>	21
	<i>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit</i>	332
	<i>Agjencia Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA)</i>	185
	<i>Komiteti Shtetëror i Kulteve</i>	10
	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	61
	<i>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</i>	23
	<i>Autoriteti Komb. Cert. Elektrik (ACESK)</i>	24
	<i>Sekretariati Teknik i KEK</i>	6
	<i>Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG)</i>	46
	<i>Avokatura e Shtetit</i>	107
	<i>Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievizion</i>	7
88	Mbështetje për shoqërinë civile	16
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	39
90	Komisioni i Prokurimit Publik	36
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	34
92	Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit	19
95	Autoriteti Drejtë e Informimit për Dokumentet ish-sigurimit	50
	Total punonjes buxhetore	82,967
	<i>Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore</i>	<i>150</i>
	Total numri i punonjësve	83,117



TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2020

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2020

në milion lekë (in million lek)

Nr.	E M E R T I M I	AN 2020	Ne % te PBB	I T E M S
I.	TOTALI TE ARDHURAVE	446,570	28.2%	TOTAL REVENUE
	Te ardhura nga ndihmat	18,000	1.1%	Grants
	<i>Nga te cilat: mbeshtetje buxhetore</i>	<i>2,500</i>	<i>0.2%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga te cilat: grante per fondin e rindertimit</i>	<i>3,000</i>	<i>0.2%</i>	<i>from which: Reconstruction Fund</i>
II.	Te ardhura tatimore	408,045	25.8%	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	290,000	18.3%	From tax offices and customs
	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	130,760	8.3%	V.A.T
	Tatimi mbi Fitimin	30,390	1.9%	Profit Tax
	Alkizat	45,300	2.9%	Excise Tax
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	41,080	2.6%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe te tjera	36,010	2.3%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	6,462	0.4%	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	23,045	1.5%	Local Taxes
	Taksa Lokale	18,422	1.2%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	4,254	0.3%	Property Tax
	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel	369	0.0%	Simple profit tax of small business
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	95,000	6.0%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shoqeror	80,840	5.1%	Social Insurance
	Sigurimi Shendetesor	13,160	0.8%	Health insurance
	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	Te ardhura Jotatimore	20,525	1.3%	Nontax Revenue
	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	1,398	0.1%	Profit transfer from BOA
	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	12,527	0.8%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	500	0.0%	Divident
	Tarifat e Sherbimeve	2,000	0.1%	Services Fees
	Te tjera	4,100	0.3%	Others
I.	TOTALI I SHPENZIMEVE	579,535	36.7%	TOTAL EXPENDITURE
1	Shpenzime Korrente	441,498	27.9%	Current Expenditures
	Personeli	81,884	5.2%	Personnel expenditures
	Paga	69,508	4.4%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	11,356	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave	240	0.0%	Bonus fund
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	780	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	Interesat	40,300	2.5%	Interest
	Te Brendshme	23,200	1.5%	Domestic
	Te Huaja	13,000	0.8%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,100	0.3%	Contingency for debt related risks
3	Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:	51,117	3.2%	Operational & Maintenance of which:
	<i>Te qeverisjes qendrore</i>	<i>48,023</i>	<i>3.0%</i>	<i>Central government</i>
	<i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i>	<i>900</i>	<i>0.1%</i>	<i>from revenues of Higher Education</i>
	<i>Te tjera jashte limitit</i>	<i>2,194</i>	<i>0.1%</i>	<i>System</i>
4	Subvencionet	1,540	0.1%	from Exceptional Revenues
5	Shpenzime per Fondet Speciale	188,372	11.9%	Subsidies
	Sigurime Shoqerore	136,968	8.7%	Social insurance outlays
	Politika te reja pensionesh	2,100	0.1%	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	45,304	2.9%	Contingency for new pension policies
	<i>Nga e cila: Mbeshtetjen shendetesore anti-COVID</i>	<i>2,500</i>	<i>0.2%</i>	Health insurance
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	4,000	0.3%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	53,485	3.4%	Local Budget expenditure
	Transferrat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	26,040	1.6%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transferte e pakushtëzuar e përgjithshme</i>	<i>18,200</i>	<i>1.2%</i>	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transferte e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specifik)</i>	<i>7,840</i>	<i>0.5%</i>	<i>Specific Grant</i>
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	23,045	1.5%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa të ndara	600	0.0%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jo-tatimore)	2,800	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	1,000	0.1%	Local foreign financing
7	Shpenzime te tjera	24,800	1.6%	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	800	0.1%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	21,000	1.3%	Social assistance and disability
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,000	0.1%	Birth Bonus
II.	Fondi Rezerve	16,200	1.0%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve	2,700	0.2%	Reserve Fund
	Kontigjenca per paketen sociale anti-COVID	13,500	0.9%	Contingency for deficit financing
III.	Shpenzime Kapitale	87,837	5.6%	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	59,153	3.7%	Domestic financing
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0.1%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi Huaj	27,684	1.8%	Foreign financing
	<i>nga të cilat: Energjia</i>	<i>1,000</i>	<i>0.1%</i>	<i>from which: Energy</i>
IV	Fondi i Rindertimit, nga të cilat:	34,000	2.2%	Reconstruction Fund
	<i>Grante</i>	<i>3,000</i>	<i>0.2%</i>	
	<i>Shpenzime</i>	<i>31,000</i>		
	DEFICITI	-132,965	-8.4%	Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	132,965	8.4%	Financing (Cash)
	Brendshem	50,371	3.2%	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi		0.0%	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	49,900	3.2%	Domestic borrowing
	Te tjera	471	0.0%	Other
	I Huaj	82,594	5.2%	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	95,361	6.0%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0		Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-62,600	-4.0%	Repayments
	Mbeshtetje buxhetore	49,833	3.2%	Budget support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	1,580,960	100.0%	Gross Domestic Product (GDP)

**VENDIM****Nr. 506, datë 24.6.2020**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA ISH-
INSPEKTORATI I KËSHILLIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, SOT
KËSHILLI I LARTË I GJYQËSORIT, TE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS
PUBLIKE DHE KOMISIONI I
PROKURIMIT PUBLIK, TË GODINËS SË
ISH-INSPEKTORATIT TË KËSHILLIT
TË LARTË TË DREJTËSISË (PJESË E
ISH-HOTEL “ARBËRIA”)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sot Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit

Publik, të godinës së ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (pjesë e ish-hotel “Arbëria”), sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Departamentit të Administratës Publike i kalon në përgjegjësi administrimi bodrumi, kati përdhes (holli), kati i parë dhe kati i dytë i godinës.

3. Komisionit të Prokurimit Publik i kalon në përgjegjësi administrimi kati i tretë dhe kati katërt i godinës.


4. Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionit të Prokurimit Publik u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e godinës së përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

5. Në pikën 1, të vendimit nr. 387, datë 19.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e destinacionit dhe administrimit të hotel ‘Arbërisë’”, fjalët “... dhe Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ...” hiqen.

6. Ngarkohen Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIM
Nr. 507, datë 24.6.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA DEPARTAMENTI
I ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
TEK INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË, TË GODINËS SË ISH-
MINISTRISË SË INTEGRIMIT
EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të godinës së ish-Ministrisë së

Integritimit Evropian, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i kalon në përgjegjësi administrimi oborri, kati përdhës, kati i parë e i dytë i godinës.


3. Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e godinës së përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


4. Vendimi nr. 704, datë 1.12.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-Ministria e Integritimit Evropian te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të godinës së ish-Ministrisë së Integritimit Evropian”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama





*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë